



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Ekonomisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Ekonomisë (ME), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Ekonomisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Si rezultat i mos respektimit të kritereve të dosjes së tenderit gjatë vlerësimit të ofertave, është shpërblyer me kontratë operatori ekonomik (OE) i cili nuk ka përmbushur kërkesat;
- A2 Mangësi në aplikimin e kërkesave të prokurimit lidhur me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për punë shtesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Ekonomisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Ekonomisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Ekonomisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Ekonomisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Fusha që kërkon më tepër fokus është menaxhimi i pasurisë ku në mungesë të kontrolleve efektive në këtë fushë kemi një prezantim jo të saktë dhe të plotë të vlerave të raportuara në PFV. Po ashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të procedurave të prokurimit për të evituar mos pajtueshmëritë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme.

Ky raport ka rezultuar me katër (4) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Mangësi në procesin e vlerësimit të tenderit

Gjetja Te aktiviteti i prokurimit “Krijimi i Qendrës për Ekselencë Dixhitale në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP)-Prizren - Laboratori RF” në vlerë 459,020€, te kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuara në dosjen e tenderit/njoftimin për kontratë, është kërkuar që OE duhet të dorëzoj listën e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit për furnizime apo shërbime të ngjashme në vlerë së paku 478,561€, e dëshmuar kjo me referencë pozitive apo raporte të pranimit teknik.

Kemi evidentuar se operatori ekonomik i shpërblyer me kontratë për këtë projekt, nuk kishte plotësuar kërkesat lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional. Krahas listë së projekteve të realizuara nuk kishte dorëzuar edhe referencat pozitive apo raportet e pranimit teknik në vlerën e kërkuar për projektet e realizuara në tre vitet e fundit. Vlera e projekteve të realizuara në tre vitet e fundit sipas listës së dorëzuar ishte 562,165€, ndërsa vlera e dëshmuar me referenca ishte vetëm 72,000€.

Kjo ishte ndikuar nga mungesa e kontrolleve efektive për shkak të mos racionalizimit të detyrave dhe ngarkesës në punë.

Ndikimi Mos plotësimi i kriterëve të kërkuara ka rezultuar me dhënie të kontratës operatorit i cili nuk ka përmbushur kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional të përcaktuara në dosjen e tenderit, përkatësisht njoftimit për kontratë.

Rekomandimi A1 Ministrja përmes personave përgjegjës të sigurojë se komisionet vlerësuese përfillin të gjitha kriteret e kërkuara me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, dhe se vendimi për dhënie të kontratës bëhet vetëm pas marrjes së sigurisë së të gjitha kërkesat janë përmbushur.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në aplikimin e kërkesave të prokurimit

Gjetja Neni 52 i Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik (RrUOPP), ndër të tjera përcakton se “kur autoriteti kontraktues përdor procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë duhet ta njoftoj KRPP-ne brenda 2 ditëve nga data e marrjes së vendimit duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP. Njoftimi duhet të nënshkruhet nga ZKA dhe zyrtari përgjegjës i Prokurimit, të skanohet të ngarkohet dhe ti dërgohet KRPP-se përmes platformës së prokurimit elektronik”. Po ashtu, neni 61 i RrUOPP ndër të tjera përcakton se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer” dhe se “Ndryshimi i kontratës nuk do t’i lëshohet Operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA”.

Te aktiviteti i prokurimit “Krijimi i Parkut të Teknologjisë Dixhitale në Bërnice - Faza III” kemi evidentuar mangësitë si në vijim:

- Ishte aplikuar procedura e negociuar e çmimit pa publikim të njoftimit për kontratë dhe ishte lidhur aneks kontrata në vlerë 66,615€ (kontrata bazë ishte në vlerë 698,600€). Mirëpo në platformën e prokurimit elektronik nuk ishte bërë njoftimi që duhet dërguar në KRPP për përdorimin e kësaj procedure, ndonëse ky dokument ishte nënshkruar nga ZKA;
- Ndërlidhur me këtë projekt, ishte bërë ndryshimi në realizimin e sasive në disa pozicione të kontratës bazë, përkatësisht rritja e sasive në disa pozicione në vlerë prej 33,880€ dhe zvogëlimi i sasive në disa pozicione tjera për të njëjtën vlerë duke mos e ndryshuar çmimin e kontratës. Mirëpo nuk ishte marrë aprovimi nga ZKA për ndryshimin e sasive.

Kjo gjendje ishte për shkak të mos respektimit të kërkesave rregullative në menaxhimin e procedurave të prokurimit. Përderisa, menaxheri i kontratës nuk ishte në njohuri se duhej marrë aprovimi i ZKA për ndryshimet e sasive të pozicioneve të kontraktuara.

Ndikimi

Mos njoftimi i KRPP-së për vendimin e përdorimit të procedurës së negociuar, ka pamundësuar që KRPP të mund të vendos të kontrolloj vendimin dhe potencialisht nëse do të ishte e nevojshme, të ftojë Ministrinë për të rishikuar vendimin e saj në përputhje me opinionin e lëshuar të KRPP-së. Ekzekutimi i punëve në kundërshtim me paramasën dhe paralogarinë e kontraktuar pa aprovimin e ZKA-së, shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti si dhe kjo mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera si dhe në përmbushjen e kontratës sipas objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi A2

Ministrja të sigurojë se KRPP njoftohet përmes platformës së prokurimit publik brenda 2 ditëve nga data e marrjes së vendimit që të përdoret procedura e negociuar pa publikim të njoftimit. Po ashtu, të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit dhe marrjes së aprovimit nga ZKA. Zhvillimi i procedurave duhet të behet në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 5,988,361€, e pasurive jokapitale është 47,967€ si dhe e stoqeve 34,107€.

Çështja C1 - Mangësi në procesin e inventarizimit/vlerësimit të pasurive jo financiare

Gjetja

Neni 19.4 i Rregullores Nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurive jo financiare, përcakton se çdo fund vit duhet të behet inventarizimi, nga komisioni për inventarizim i cili ndër të tjera është përgjegjës edhe për: verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së pasurisë jo financiare dhe krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, në anën tjetër neni 21 ka përcaktuar përgjegjësitë e komisionit për vlerësimin e pasurive jo financiare.

Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer pas datës së raportimit të PFV. Rrjedhimisht, nuk ishte bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Raportimi i pasurive në PFV ishte bërë sipas regjistrit kontabël.

Në anën tjetër, procesi i vlerësimit të pasurive kishte përfunduar para atij të inventarizimit, edhe pse sipas kërkesave rregullative puna e komisionit për inventarizimin e pasurive është bazë e punës së komisionit për vlerësimin e pasurive jo financiare. Në anën tjetër, komisioni vlerësues nuk kishte bërë vlerësimin e pasurive me vlerë zero në regjistrin e pasurive kapitale e të cilat janë ende në përdorim.

Mangësitë në procesin e inventarizimit si dhe procesin e vlerësimit të pasurive, kryesisht ishin për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare.

Ndikimi

Vonesat në procesin e inventarizimit, përkatësisht mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë. Po ashtu, mos vlerësimi i pasurive me vlerë zero ka ndikuar në nënvlerësimin e regjistrit të pasurive kapitale.

Rekomandimi C1

Ministrja duhet të siguroj se procesi i inventarizimit të pasurive do të kryhet sipas kërkesave për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, si dhe pasi të jetë hartuar një raport i përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë, të krahasohet gjendja e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare për të korrigjuar gabimet e mundshme. Raporti duhet të përfshijë rekomandime të qarta të cilat do të jenë bazë për punën e komisionit të vlerësimit të pasurisë. I gjithë ky proces duhet të përfundoj para përgatitjes së PFV për vitin 2024. Po ashtu, duhet të bëhet vlerësimi i pasurive me vlerë zero e të cilat janë ende në përdorim me qëllim të pasqyrit të gjendjes së saktë dhe të drejtë në regjistrat e pasurive të ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C2 - Mangësi në regjistrimin e pasurive**Gjetja**

Neni 5 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare ka përcaktuar klasifikimin e pasurive, ndërsa neni 6.1 përcakton se “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj”.

Vlera e pasurive në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV) ishte nënvlerësuar për 276,338€ si rezultat i klasifikimit jo të drejtë të pasurisë në regjistër si dhe regjistrimit të dyfishtë.

Ndërtesa e Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve ishte klasifikuar si kapital tjetër duke u zhvlerësuar me normë të zhvlerësimit 10 vite, ndërsa do të duhej të klasifikohej si ndërtesë jo rezidenciale me normë të zhvlerësimit 40 vite. Rrjedhimisht, vlera neto në libra (VNL) në regjistrin e pasurive kapitale është nënvlerësuar për 391,749€. Përveç kësaj, në regjistrin e pasurive ishte përfshirë vetëm ndërtesa sipas vlerës së investimit 559,642€, por jo edhe eksponatet e kristaleve dhe mineraleve të cilat janë të ekspozuara në muze.

Po ashtu, regjistri i pasurive kapitale ishte mbivlerësuar për 115,411€ për shkak të regjistrimit të dyfishtë të pajisjeve kapitale.

Nënvlerësimi i pasurive kapitale kishte ndodhur për shkak të regjistrimit në klasën e gabuar të pasurive, si dhe për shkak të gabimeve teknike në regjistrimin e tyre.

Ndikimi

Klasifikimi jo i drejtë i pasurive me rastin e regjistrimit, dhe regjistrimit i dyfishtë kanë ndikuar në aplikimin e pasaktë të normës së zhvlerësimit duke shkaktuar nënvlerësimin e vlerës së pasurive në regjistra. Kjo ka rezultuar me pasqyrimin jo të saktë dhe të drejtë të pasurive kapitale në PFV.

Rekomandimi C2

Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosjet në PFV të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë. Po ashtu, duhet të bëhet vlerësimi i pasurive me vlerë zero e të cilat janë ende në përdorim me qëllim të pasqyrimin të gjendjes së saktë dhe të drejtë në regjistrat e pasurive të ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final ⁵ | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|--|-------------------|----------------------------|-------------------|--------------------|-------------------|
| Burimet e fondeve | 52,850,827 | 90,666,834 | 57,655,068 | 178,300,277 | 64,241,822 |
| Grante Qeveritare - Buxheti | 17,019,892 | 54,835,899 | 51,933,772 | 173,399,369 | 57,890,943 |
| Financimi përmes huamarrjes | 13,194,260 | 13,194,260 | 5,577,011 | 3,476,681 | 2,801,997 |
| Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve | 22,636,675 | 22,636,675 | 144,285 | 1,424,226 | 3,548,882 |

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është rritur për 37,816,007€. Ky ndryshim vjen si rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë në fushën subvencione dhe transfere për mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike, përkatësisht subvencionim të energjisë elektrike për konsumatorët fundor, si dhe mbështetje për ndërmarrjet publike me vështirësi financiare. Kjo rritje, po ashtu, është si rezultat i zbatimit të Ligjit të ri të pagave në sektorin publik.

Në vitin 2023 ME ka shpenzuar 57,656,974€ apo 64% të buxhetit final, derisa në vitin paraprak, niveli i realizimit ishte 92%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Shpenzimet | 2022 Shpenzimet | 2021 Shpenzimet |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|--------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike | 52,850,827 | 90,666,834 | 57,655,068 | 178,300,277 | 64,241,822 |
| Pagat dhe mëditjet | 1,166,122 | 1,383,381 | 1,383,381 | 1,142,374 | 1,208,881 |
| Mallrat dhe shërbimet | 6,713,041 | 5,839,985 | 2,012,538 | 1,558,983 | 997,848 |
| Komunalitë | 23,130 | 23,130 | 13,342 | 11,333 | 7,783 |
| Subvencionet dhe transferet | 12,134,150 | 54,613,655 | 50,990,756 | 171,491,629 | 53,312,839 |
| Investimet Kapitale | 32,814,384 | 28,806,683 | 3,255,051 | 4,095,958 | 8,714,471 |

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar kishte pësuar rritje në vlerë prej 217,259€ dhe i njëjti ishte shpenzuar 100%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 873,056€. Kjo si rezultat i vendimit të Qeverisë për ridestitim të fondeve prej 375,150€ nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë Subvencione dhe transfere për përkrahje financiare për NP Trepça, si dhe si rrjedhojë e vendimeve të Qeverisë për kursime prej 497,906€. Shuma e shpenzimeve të realizuara në këtë kategori është vetëm 35%. Kjo përqindje ishte pasojë e progresit të ulët financiar lidhur me programet për financimin e sektorit të ujërave në Komunën e Prishtinës.


Buxheti final për shpenzime komunale në raport me buxhetin fillestar nuk kishte pësuar ndryshime dhe ishte 23,130€. Ky buxhet ishte realizuar vetëm 58%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar është rritur për 42,479,505€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve buxhetore me vendime të Qeverisë për mbulimin e një pjese të faturave të energjisë për konsumatorët fundor në vlerë rreth 24,600,000€, si dhe për zbatimin e masës 4 të Planit të veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike në vlerë prej 5,000,000€. Po ashtu, për zbatimin e masës 3.7 Mbështetje në tejkalimin e krizës energjetike të Pakos së Ringjalljes ekonomike në vlerë prej 7,278,748€, dhe sipas vendimeve të Qeverisë për aprovimin e kërkesave të ministrisë për transfer/rialokim në vlerë prej 2,395,150€ si dhe sipas vendimit për kursime dhe ndarje prej 3,205,607€. Shuma e shpenzuar për këtë kategori ishte 50,990,756€ apo 93% e buxhetit final për këtë kategori.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,007,701€ si rezultat i rregullimeve të brendshme dhe deklarimeve për kursim. Mjetet në vlerë 1,300,000€ nga kjo kategori janë transferuar sipas vendimeve të Qeverisë në kategorinë subvencione dhe transfere, ndërsa shuma prej 2,707,701€ është deklaruar në kursime. Përkundër këtij zvogëlimi vetëm 11% e buxhetit ishte shpenzuar gjatë vitit 2023. Ky nivel i ulët i realizimit ishte si rezultat i planifikimit të dobët të NP-ve të cilat kanë qenë bartëse të planifikimit dhe të realizimit të projekteve të financuara nga huaja.

Sa i përket ndarjeve për “Programin e ringjalljes ekonomike”, nga kodi i projektit (00098) në kategorinë subvencione dhe transfere janë ndarë dhe shpenzuar mjete në vlerë prej 32,598,748€. Qëllimi i këtyre mjeteve ishte subvencionimi i energjisë elektrike për konsumatorët fundorë, me qëllim të uljes së ndikimit të tarifave të energjisë, e cila pastaj reflektohet edhe në faturat e konsumatorëve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga ME në 2023 ishin në vlerë 121,161€. Pjesa më e madhe e të hyrave në vitin 2023 ishin realizuar nga proceset gjyqësore/përmbarimore të iniciuara nga ministria në vitet paraprake në vlerë 110,452€, të hyrat nga aktivitetet e rregullta ishin prej 7,444€, përderisa të hyrat nga viti i kaluar ishin 3,265€. Duhet theksuar se buxheti final i prezantuar në tabelë është sipas projeksionit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, përderisa projeksioni i ME ishte prej 8,000€. Këto të hyra shkojnë në llogarinë kryesore të Thesarit dhe nuk shfrytëzohen nga ME.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti final | 2023 Pranimet | 2022 Pranimet | 2021 Pranimet |
|---------------------------|-------------------|----------------|----------------|---------------|---------------|
| Totali i të hyrave | 472,108 | 472,108 | 121,161 | 1,113 | 2,400 |
| Të hyrat jo tatimore | 472,108 | 472,108 | 117,896 | 1,113 | 2,400 |
| Të hyrat tjera | 0 | 0 | 3,265 | | 0 |

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 ka rezultuar në pesë (5) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Çështjet që kanë ndikuar në kualifikimin e opinionit financiar për vitin paraprak ishin adresuar dhe rekomandimet ishin zbatuar. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, tre (3) rekomandime ishin zbatuar si dhe dy (2) ishin pjesërisht të zbatuara.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

| Nr | Fusha e Auditimit | Rekomandimet e vitit 2022 | Veprimet e ndërmarra | Statusi |
|----|------------------------|--|--|----------------------|
| 1. | Baza për opinion | Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosjet në PFV të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të drejtë. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për organizatat tjera, të barten tek përfituesit duke i larguar nga regjistrat e ministrisë. | Ministria ka zbatuar rekomandimin e vitit të kaluar për pjesën e transferimit të pasurive që nuk janë në pronësi të saj. Mirëpo edhe në këtë vit kemi hasur gabime në regjistrimin e pasurive. | Pjesërisht i zbatuar |
| 2. | Baza për opinion | Ministrja duhet të siguroj që mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore, dhe të sigurohet se detyrimet kontingjente prezantohen drejtë dhe saktë në PFV-të e vitit 2023. | Nuk kemi hasur raste të tilla në vitin 2023. | I zbatuar |
| 3. | Çështjet e përbashkëta | Ministrja duhet të siguroj se “Deklarata e Nevojave dhe e Përcaktimit të Disponueshmërisë së Mjeteve” shqyrtohet nga personat e autorizuar për nënshkrim të kontratave para publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës me qëllim që të ri konfirmojë se informatat financiare nuk kanë ndryshuar ose në rastet kur ndodhin ndryshimet të paraqiten informacionet e modifikuara. | Nuk kemi hasur raste të tilla në vitin 2023. | I zbatuar |
| 4. | Pasuritë | Ministrja duhet të sigurojë se komisioni për inventarizim të pasurisë ka informata të plota për të gjitha pasuritë që janë në përdorim dhe në pronësi të ministrisë pavarësisht nga vendndodhja e tyre, si dhe pas inventarizimit të gjitha ndryshimet duhet të pasqyrohen në regjistrin e pasurive. | Inventarizimi ka përfshirë të gjitha pasuritë e Ministrisë, ndonëse përsëri kemi hasur mangësi ngase ishte kryer me vonesë. | Pjesërisht i zbatuar |
| 5. | Auditimi i Brendshëm | Ministrja duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Njëkohësisht të përmbushen objektivat e planifikuara në planin vjetor të punës në përputhje me resurset në dispozicion. | Ministria ka angazhuar një zyrtar shtesë në kuadër të NjAB-së si dhe ka përmbushur planin vjetor të auditimit. | I zbatuar |

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Ganimete Dalloshi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

| | | | |
|---|---|-------------------------------------|--|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE | | | |
| DATEPËRMBIMIA PËR ORGJANIZATËN ACTING SPECIAL AUDITING OFFICER DATE OF RECEIPT BY THE ADDRESSEE | | | |
| 31-05-2024 | | | |
| Mirësi Ora- Org. Jedin. Org. Unit | Shtetësi/ Klasif. Kod Classif. Code | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. | Nr.faqeve Br. Stranica No. Pages |
| 03 | 47 | 698 | 1 |



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo ekonomije, Ministry of Economy

| | | | |
|--|-------------------------------------|-----------------|--|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY | | | |
| Nivelo Org. Org. Jedin. Org. Unit | Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. | 4606 | |
| Nr. i faqeve Br. stranica No. pages | Datum: Date: | 30.05.24 | |
| 1 | | PRISHTINEA NO.1 | |

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Ekonomisë, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.


Artane Rizvanolli
Ministre – Ministria e Ekonomisë, Prishtinë
Data: 30 qershor 2024.



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.